



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

### Procesverbal nga mbledhja e XXVII-të (njëzeteshtatë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 06 nëntor 2024

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10;10

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli, znj.Fikmete Qurkolli, kurse mungoi, z.Arbnor Fazliu.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK; Makfirete Zeka-U.D Drejtoresh e Qendrës për Punë Sociale QPS në Podujevë; Driton Shabani nga Stacioni i Policisë në Podujevë; Bekim Karaxhija përfaqësues i OSBE; Zita Rasztik dhe Gabor Valler përfaqësues të KFOR.

### Rendi i ditës

**z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit**, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj mirëseardhje në këtë mbledhje, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, andaj në vazhdim po i lexoj rendin e ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

*Njzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e Komitetit prezent në mbledhje, miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.*

#### 1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 10.10.2024

*Njzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e pranishëm në sallë, miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshim procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

#### 2. Informatë nga Enti i Punësimit / Zyra e Punësimit rreth evidentimit të kërkuësve për punë dhe trajnimeve për treg pune nga radhët e Komuniteteve jo shumicë.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, meqë për momentin nuk është i pranishëm përfaqësuesi nga Zyra e Punësimit, këtë pikë të rendit të ditës e tejkalojmë për diskutuar në vijim po sa të jetë prezent zyrtari përkatës, kështu që tani fillojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

### 3. Informatë nga Qendra për Punë Sociale për gjendjen ekonomike-sociale dhe familjet nga radhët e komuniteteve jo shumicë që janë në asistencë sociale.

**znj.Makfirete Zeka**, U.D drejtoreshë e Qendrës për Punës Sociale-QPS, e paraqiti informatën në fjalë, theksoi, unë në cilësinë e drejtoreshës së Qendrës për Punë Sociale jam e thirrur që të jap një informatë për familjet që janë në skemë sociale edhe pse gjatë takimeve që i kemi mbajtur e kemi thënë që nuk e kemi bërë atë ndarje ndërmjet komuniteteve por jemi thirr gjithmonë se edhe këta janë qytetarë të Komunës ton dhe nga gjithsej sa kemi tani momentalisht 569 persona që janë në skemën sociale, 52 prej tyre janë persona që i takojnë komunitetit ashkali me 272 anëtarë të familjes gjithsej.

Përveç kësaj e kemi një familje 8 anëtarë të komunitetit rom që janë në asistencë sociale.

Për të folur për gjendjen ekonomike sociale në bazë të numrit të anëtarëve të komunitetit rom dhe ashkali janë të përfshirë në skemat sociale shumica e tyre, kushtet ekonomike dihet mirëfilli i kësaj ku mund ta them kushtimisht që rastet që kanë kaluar apo janë larguar nga skema sociale janë komuniteti që jeton në rrugën “Ali Ajeti” që janë integruar dhe kanë bërë zgjidhje dhe një gjë që është më shqetësuese është lagja “Xhafer Meta” që janë një numër më i madh në skemën sociale edhe pse zakonisht kur paraqiten te ne në QPS, ne ju tregojmë kriteret se çka duhet të kenë sepse ka persona mbi 18 vjet që janë të aftë për punë i cili ka mundësi të bëjë zgjidhje për një vend të punës, mirëpo këto janë statistika megjithëse duket qartë që ka persona që kanë gjetur zgjidhje dhe janë larguar nga skemat sociale edhe pse kriteret janë bukur shumë të ashpra sepse një anëtar i familjes punon për një muaj ose dy, administrata tatimore menjëherë ja dërgon vërejtën se punoni një anëtar i familjes, por tash është më mirë sepse është sistemi i ri i skemës sociale e cila ka kritere shumë më të buta ku ata e llogaritin për kok banori dhe ka mundësi që një anëtar i familjes të punoj ata llogariten të hyrat se sa mund të jenë për kok banori dhe janë më të lehta kështu që kemi filluar me skemën e re sociale ku aplikimi bëhet përmes e-Kosova dhe rastet që lajmërohen vjen lista te ne, ku është formuar komisioni për skemë sociale dalin e verifikojnë gjenden faktike në teren dhe ata e japin një mendim për kushtet ekonomike sociale, pra ky sistem është më i favorshëm për qytetarët kështu që në përgjithësi është në rënje numri i familjeve me asistencë sociale dhe është më mirë se kush gëzon shëndet të mirë të punoj në një vend të punës dhe të ketë një pagë më të mirë. Kjo është sa unë kam të dhëna lidhu me këtë temë të diskutimit.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, mund të theksoj që në rrugën “Ali Ajeti” 13 persona kanë qenë në asistencë sociale dhe tash të gjithë janë të punësuar, ku e kanë parë që më mirë është të punosh dhe janë larguar nga asistencë sociale dhe nuk qëndron më ajo që unë po marr social dhe nuk dëshiroj të punoj, sepse me qëndrua në shtëpi i shëndosh dhe duhet të dilet të punohet, sepse vetëm ai që është me kushte të rënda duhet të marr socialin dhe si përfundim në lagjen ton ka përmisime dhe kanë filluar të punojnë, ndërsa në lagjen “ Xhafer Meta” nuk e di se si është gjendja dhe nuk kam informata të sakta në qoftë ka ndonjë informatë Shkurta mund të na prezanton.

**znj.Makfirete Zeka**, U.D drejtoreshë e QPS, theksoi, vetëm edhe diçka dua të shtoj, në asistencë sociale më së shumti kemi familje të lagjes “Xhafer Meta” janë afër 70% dhe gjendja e rënd e tyre ku dihet edhe mirëfilli, pra te kjo lagje nuk është që kanë bërë zgjidhje për punë po e shoh që janë duke hezituar dhe me një fjalë nuk janë të integruar si që është pjesa tjetër te “Ali Ajeti”, dhe për ndryshe kur po flasim për asistencë sociale ne si komunë që jemi më e madhe me territor edhe me banor por rastet e asistencës sociale janë në rënie e sipër që është shumë e mirë, dhe është kënaqësi për mua sepse e kanë kuptuar njerëzit se skema sociale është vetëm për ata që nuk gëzojnë shëndet të mirë apo për nënat vetë ushqyese dhe shpesh kur bisedojmë me ata lidhur

me kriteret e skemës sociale dhe ata normal që mundohen me bë një zgjidhje dhe është me e favorshme për familjen që të ketë një vend të punës.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, duhet të them edhe një gjë, një kushte që i kushtëzon jo vetëm familjet rom ashkali egjiptian por edhe tek të tjerët, shembull janë dy vëllezër në një shtëpi ku njëri e merr socialin ndërsa tjetri nuk e merr me arsyetimin se janë në një shtëpi dhe kjo është një pengesë që nuk është faji i juaj por ligji e ka paraparë ashtu, pra kjo është një breng e sidomos te komuniteti sepse nuk kanë tjera shtëpi dhe nuk kanë vend për të ndërtuar një të tillë kështu që kemi edhe problem familjar tash kur një përfiton dhe tjetri jo aty po lind edhe problemi familjar.

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, drejtoresha e QPS në mënyrën më të mirë e shpjegoj këtë dhe statistikën i dha të sakta, dhe ajo që më pëlqeu mua është që asistencë sociale ka rënie dhe duke e parë tregun e lirë të punës njerëzit dhe tash njerëzit janë përcaktuar të punojnë edhe në sektorin privat dhe ka kërkesa si në gastronomi, ekonomi, bujqësi pra në të gjitha fushat dhe është mirë sepse e kanë një pagë më të mirë, dhe është interes i tyre edhe familjar ku edhe e theksove që 13 prej tyre veç kanë filluar të punojnë ku ndërmarrja i merr dhe i kanë të përfshira me transport dhe ushqim dhe është mirë që janë duke u plotësuar këto kushte për punë sepse në takimet që i mbajmë ne shpesh herë i marrim informacionet që tash po gjejnë punë dhe po vijnë nga shtet tjera dhe po gjejnë punë në Kosovë, dhe termi jam i papunë në Kosovë nuk është më i interesant është fjala në qoftë se je i shëndosh për punë sepse po vijnë qytetarë nga vendet e ndryshme si Turqia Bangladeshi dhe të tjera dhe po gjejnë punë këtu pra kjo është e mirë sepse njerëzit kanë krijuar vetëdije dhe e kanë kuptuar që pa punë nuk munden dhe puna është jetë. Sa i përket lagjes “Xhafer Meta” e dini që unë i kam vizituar të gjithë, ku familja Behluli janë anëtarë më shumë ku 65 anëtarë janë për afërsisht dhe në asistencë sociale janë më shumë por edhe me banor dominojnë aty, besoj që edhe te këta gradualisht do të ketë rënie, por megjithatë Qendra për Punë Sociale i ka kriteret e veta dhe ju ndihmon dhe është mirë që ju ndihmon. Ne kemi pasur edhe takimin më herët prej kabinetit të Kryeministrit dhe me Ministrin e Pushtetit Lokal, ku është diskutuar për martesat e hershme që kjo dukuri është në rënie, pra nuk kanë qenë të përgatitur për jetë dhe është normale që është dashtë të hyjnë në skemën sociale, por megjithatë e përgëzoj drejtoreshën që na dha të gjitha këto informacione dhe me gëzon fakti që asistencë sociale është në rënie dhe qytetarët janë të aftë të punojnë.

**znj.Sevdije Mustafa**, theksoi, unë vetëm do të doja që të falënderoja drejtoreshën e Qendrës për Punë Sociale dhe jam shumë e kënaqur që të gjithë banorët janë të barabartë dhe ju falënderoj për punën që po e bëjnë për komunitetin ton.

**z.Demokrat Hodolli**, theksoi, dëshiroj të pyes drejtoreshën se sa ka qenë numri më i madhe i familjeve që kanë përfituar asistencë sociale.

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, theksoi, unë mundem që ti përgjigjem, shembull e kam një statistikë 2022-2023, ku në këtë vite sipas statistikës që i kam marr, komuniteti shumicë i ka pasur 880 familje ndërsa tash janë 300 familje më pak pra kanë qenë nga komuniteti 4037 anëtarë të familjes pra është fjala për komunitetin jo shumicë, ndërsa në komunitetin jo shumicë kanë qenë 66 familje ashkali dhe tash janë 52 kiu kanë qenë 353 anëtarë dhe tash komuniteti ashkali i ka 270 anëtar, komuniteti rom kanë qenë 5 familje e tash janë vetëm 1 familje me 8 banor ndërsa kanë qenë 37 banor, pra kur te shikosh totalin te komuniteti jo shumicë kanë qenë 71 familje me 390 anëtarë dhe në total kanë qenë 887 familje me 4037 banor dhe tash kemi rënie te numri i tyre dhe është mirë që ka rënie sepse qytetarët janë punësuar dhe janë integruar.

**znj.Makfirete Zeka**, U.D drejtoreshë e QPS, theksoi, e përmenda që gjatë viteve 2020 kanë qenë afër 1000 raste në përgjithësi, mirëpo duke e pasur parasysh territorin dhe banorët që i ka komuna jon ka rënje të konsiderueshme dhe tash me 570 raste pra kanë gjetur zgjedhje janë punësuar dhe i gëzohemi faktit që kanë gjetur zgjidhje dhe nuk janë në asistencë sociale, pra skema sociale është për raste të veçanta dhe kur nuk gëzon shëndet të mirë dhe për nënat vetushqyese, mos te harrojmë është masa 1.8 e Ministrisë të Drejtësisë që ka pasur mundësi që nënat që kanë mundësi për të punuar dhe sa herë kanë ardhur te ne i kemi thënë që nëse kanë mundësi munden të punojnë si në sektorin privat, por shumica nuk kanë pasur mundësi por kemi raste kur ato edhe janë punësuar, por si numër është i kënaqshëm për njerëzit që kanë bërë zgjidhje dhe numri me asistencë sociale në komunën tonë nuk është shqetësuese.

### **Informatë nga Enti i Punësimit / Zyra e Punësimit rreth evidentimit të kërkuesve për punë dhe trajnimeve për treg pune nga radhët e Komuniteteve jo shumicë.**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës ne pritëm që po vie drejtoresha e këtij institucioni për të na paraqitë informata e nevojshme, mirëpo meqë ne nuk erdhi, ne po mundohemi të diskutojmë për këtë pikë të rendit të ditës, mirëpo në takimin e radhës do ta thërrasim sërish që na jap informacionet e nevojshme.

**z.Liman Zeqiri**, shef i ZKKK, theksoi, e falënderoj drejtoreshën për informatat që na ofroj, besoj që me rend të ditës kanë qenë të njoftuar të gjitha por arsyet pse nuk ka ardhur unë nuk e di, mirëpo më mirë do të ishte që zyra e punësimit të ishte këtu sot që të na jep informacione, por megjithatë ne si ZKK kemi informacione dhe koordinim të vazhdueshëm, sepse ne merrmi me procesin e riatdhesimit dhe kur kemi të bëjmë me këtë çështje njerëzit vijnë tek ne si komuniteti shumicë ashtu edhe komuniteti jo shumicë vijnë pra tek ne në zyrën tonë tek zyrtari për integritime evropiane i merr të dhënat e tyre dhe normalisht i orienton që të shkojnë në entin e punësimit, ku më pastaj enti i punësimit i dërgon në qendrën për përgatitje profesionale në Prishtinë dhe më pastaj i marrin edhe certifikatat sepse certifikohen për ato punë biznese apo çka kanë dhe me ato biznese shpesh janë edhe programet ku UNDP i ndihmon me projekte, ku në vitin e kaluar UNDP ka pasur shumë projekte që ka ndihmuar, ku në përgjithësi 31 projekte i kanë fituar ndërsa në mesin e këtyre projekteve kanë fituar edhe komuniteti jo shumicë, pra përveç kësaj ne kemi marrëdhënie të mira edhe me IOM pra organizata ndërkombëtare për migrim, ku më së shumti kjo organizatë ju ndihmon komuniteteve jo shumicë por normal shpesh herë statistikën i marrim edhe nga Enti i Punësimit, statistikën në bazë të vitit të kaluar që unë i kam se kjo mund të ndryshoj rrethanat apo situatat në çdo muaj ku nga komuniteti jo shumicë për punë janë lajmëruar 21 persona për punë dhe është mirë se enti i punësimit i koordinon punët si në sektorin publik ashtu edhe privat, ku sektori privat kërkon punë nga enti i punësimit për profesione të ndryshme që janë të aftë për të punuar, me siguri që ne do të marrim edhe ndonjë informatë të saktë nga enti dhe normale në bazë të koordinimit që ne kemi me entin, ne i kemi statistikën. Përveç kësaj normalisht janë edhe organizatat tjera ndërkombëtare që ju ndihmojnë si që është organizata nga Gjermania Ura, UNDP, IOM e organizata tjera pra këto ju ndihmojnë atyre familjeve në mënyrë që të ri integrohen, pra kjo është ajo tema që ne merrem me entin e punësimit rreth personave të riatdhesuar, ku para disa ditësh kanë qenë dy persona që janë lajmëruar dhe unë kam qenë prezent aty, ku ne i informojmë dhe i drejtojmë se ku duhet të shkojnë dhe ku të gjejnë punë. Përveç kësaj ne i merrem edhe me Departamentin e Punëve të

Brendshme që ka të bëjë me strehimin, pakot ushqimore dhe mobileri, por këtë çështjet e mëdha të ndërtimi dhe rindërtimi i ka Ministria e Punëve të Brendshme Departamenti për Ri Integrim, mirëpo aty ka edhe komision për ri integrim për të gjithë qytetarët pa dallim etnie, pra na i udhëzojmë për në departamentin e ri integrimin në Ministrinë e Punëve të Brendshme së bashku me koordinator që është rajonal dalin në vizita dhe ju ndihmojnë rreth këtyre temave.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, unë propozoj që të thirrem prapë drejtoreshën sepse kam arsyeje ku kam shumë të rinj të cilët janë të interesuar që të mësojnë “zanatin” apo punën në mënyrë që të punësohen më lehtë sepse kur një person po e ka të kryer ndonjë zanat po punësohet më lehtë, Më herët unë si organizatë joqeveritare i kemi dërguar disa në Don Bosko ku janë trajnuar atje dhe kanë marr diploma dhe disa kanë bërë trajnime këtu në Podujevë përmes organizatës sime dhe të gjithë janë të punësuar, ku së fundi një prej tyre ka ardhur te unë dhe më është falënderuar sepse këto diploma tash po njihen edhe jashtë shtetit, kështu që nëse do të kishte ndonjë trajnim nga enti pse mos ti dërgojmë jo vetëm të komunitetit pakicë por edhe ata shumicë, prandaj unë propozoj që të thirret prapë drejtoresha.

**znj.Makfirete Zeka**, U.D drejtoreshë e QPS, e paraqiti informatën në fjalë, theksoi, dua të theksoj që te Qendra për Punë Sociale është një praktikante juriste me emër Fitore Sejdiu që është duke e kryer punën praktike, më gëzon fakti që ajo vajzë është e profilizuar dhe është integruar shumë mirë dhe po kryen punë shumë të mira, në fillim ka hezituuar mirëpo i kam thënë që të ndjehet si në shtëpi të saj përndryshe më gëzon fakti që të kem të ri tjerë nga komuniteti që janë me profile të ndryshme të studimeve, pra këtë e përmenda si fakt që është integruar shumë mirë dhe sinqerisht ndihem shumë mirë me atë vajzë.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, për të vërtetuar fjalët tua e nderuara drejtoreshë, një mbesë e imja është duke e bërë një punë praktike në një Bankë dhe është pritur tepër mirë sepse e kemi pyetur ne se si ke kaluar dhe si të kanë pritur, pra aq mirë e kanë pritur sa që as vetë nuk e ka besuar që do të ndodhte ashtu, prandaj në këtë aspekt nuk kemi problemi por vetëm është mirë të gjejmë vende ku të punojnë, pra me një fjalë në Komunën e Podujevës komuniteti është i avancuar, përveç kësaj edhe nusja e djalit është punësuar në Polici këtu në Podujevë kështu që ata që dëshirojnë të punojnë mund të punojnë.

#### 4. Të Ndryshme

**z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit**, theksoi, e kam një lajmë për të ju dhënë, UNMIKU para 1 jave ka qenë në vizitë te unë si kryesues i komitetit ku më ka thirrur dhe i ka sjell 40 çanta për libra, unë nuk i kam marr për bashkë me UNMIKUN i kemi dërguar te shkolla “Ibrahim Rugova” 20 copë dhe 20 copë tjerë te shkolla “Naim Frashëri”, pra i kemi ndarë në dy shkolla ku edhe drejtorët na kanë falënderuar për këtë.

*Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komiteti e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 10:35**

**Procesverbalin e mbajti,  
Arbrim Idrizi**

**Nr.Prot.01-060/04-0072732/24  
Podujevë, 06 nëntor 2024**

**Kryesuesi i Komitetit  
Xhafer Ademi**